



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT DHE FORMATIT TË STANDARTIZUAR TE RAPORTIMIT FINANCIAR TE FUSHATES ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 08.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

Objekt: Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Baza Ligjore: Neni 21, pika 1, pika 15, neni 90, pika 1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" neni 15/2, pika 2, gërma (a) neni 24/3, pika 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10.02.2011

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e perfaqësuesve të partive politike,

VËREN

1. Kodi Zgjedhor në nenin 21, pika 15 përcakton si kompetencë të KQZ-së kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore në përputhje me rregullat e përcaktuar nga ky Kod, përkatësisht në pjesën VII, Kreu II, "Financimi i Zgjedhjeve". Financimi i partive politike, nga burime financiare, publike dhe jo publike, monetare dhe materiale, rregullohet dhe nga dispozitat e ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar



Nr. 256 i Vendimit Data 08.05.2019 e Vendimit Ora 10.00 e vendimit

Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

2. Në zbatim të nenit 15/2, pika 2, gërma a e ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10.02.2011, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të hartojë dhe miratojë rregullat për raportimin e financimit, për monitorimin, mbikqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike si edhe formatet e standartizuara për raportimin financiar vjetor.

3. Neni 23/1, pika 1 e Ligjit 8580 parashikon se çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit.

4. Neni 24/3, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se çdo parti politike që është regjistruar në zgjedhje duhet të bëjë publik dhe të dorëzojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një raport për deklarimin financiar të fushatës, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët e veta përbërëse, brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.

Raporti përmban në mënyrë të saktë:

a) të ardhurat e përfituara apo që ka në gjendje partia politike, duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve;

b) të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, duke detajuar çdo shpenzim që i është bërë fondit financiar të dhënë për shpenzimet e fushatës zgjedhore;

c) bilancin e pasurive dhe detyrimeve që ka partia politike, për periudhën nga data e caktimit të datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

3. Çdo parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje i mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare, dokumentacionin e plotë dhe të detajuar të gjendjes financiare të saj dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar nga raporti, duke përfshirë:

a) librat e mbajtjes së llogarive, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku evidentohen të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, duke e identifikuar mënyrën se si është kryer pagesa, si dhe të gjitha pagesat e kryera ndaj personave të tretë, qëllimi i pagesës dhe mënyra se si është kryer pagesa;

b) dokumentacion të saktë për të gjitha shpenzimet e kryera;

c) gjendjen dhe lëvizjet në llogaritë bankare të saj;

ç) dokumentacionin e plotë të pasurive të paluajtshme në pronësi ose posedim të partisë politike, si dhe çdo kontratë të lidhur për huapërdorje, qira, porosi, apo shitje, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;

5. KQZ, në zbatim të dispozitave të sipërcituara, duhet të miratojë formatin e standartizuar për raportimin financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Partitë Politike dhe kandidatët për kryetarë të bashkive, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore duhet të regjistrojnë, dokumentojnë dhe raportojnë financimin e fushatës zgjedhore. Për të përmbushur këtë detyrim KQZ duhet të miratojë formular tip raportimi I cili do të ndihmojë kandidatët për kryetarë bashkie dhe partitë politike që të përmbushin detyrimet e raportimit të financimit të fushatës.

6. Kandidatët për kryetarë bashkie duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë raportin e financimit të fushatës tek personi përgjegjës për financat i partisë. Personi përgjegjës për financat i partisë më



Nr. 256 i Vendimit Data 08.05.2019 e Vendimit Ora 10.00 e vendimit

Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

pas do të përfshijë informacione të caktuara nga kandidatët për kryetarë bashkie në raportin perfundimtar të Partisë Politike.

3. Formulari tip i raportimit përmban seksionet e mëposhtme:

1. Informacion për subjektin zgjedhor, pasqyra financiare dhe deklarata
- 2a. Të ardhura nga fondet publike
- 2b. Të ardhura nga dhurime monetare jo-publike (private)
- 2c. Të ardhura nga dhurime në natyrë jo-publike (private)
- 2d. Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti zgjedhor
3. Kreditë dhe borxhet e tjera
- 4a. Shpenzime të kryera nga partia
- 4b. Raportet e kandidatëve për kryetare bashkie
- 4c. Shpenzimet për mitingje në fushatë

Pjesë e rëndësishme e formatit të standartizuar janë dhe dy udhëzueset për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike dhe kandidatët për kryetarë bashkie.

7. Udhëzuesi për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë bashkie ka për qëllim të shpjegojë aspektet kryesore të bazës ligjore dhe të ndihmojë kandidatët për kryetarë bashkie që të përmbushin detyrimet e raportimit të financimit të fushatës. Ky udhëzues është i ndarë në dy seksione. I pari paraqet një pasqyrë të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë fushatat zgjedhore për kandidatët për kryetarë bashkie. Seksioni i dytë jep udhëzime për plotësimin e formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore të kandidatëve për kryetarë bashkie.

8. Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar të partive politike synon të shpjegojë aspektet kryesore të bazës ligjore dhe në veçanti të ndihmojë partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, që të raportojnë financat e fushatës për organet e qeverisjes vendore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Ky udhëzues është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë paraqet një pasqyrë të bazës ligjore që rregullon aspektet e financimit të fushatave zgjedhore, pjesa e dytë ofron udhëzime për plotësimin e Raportit Financiar të Partive politike për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore.

6. Miratimi i formularit tip dhe udhëzuesit përkatës për plotësimin e tij synojnë:

- Rritjen e transparencës në lidhje me fondet e perfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për qëllime të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, duke qenë se formati përmban detaje të hollësishme si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet. Gjithashtu formati pas plotësimit do të dorëzohet në KQZ dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së menjëherë me përfundimin e fushatës zgjedhore.
- Lehtësimin e raportimit nga ana e subjekteve zgjedhore për fondet e perfituara dhe të shpenzuara për qëllime të fushatës zgjedhore. Në format raportohen veçmas dhe në mënyrë të detajuar fondet publike dhe fondet jopublike. Raportimi i pranimit të fondeve jopublike bëhet në mënyrë të detajuar dhe veçmas për fondet jopublike monetare, fondet jopublike në natyrë si edhe fondet jopublike të krijuara nga vetë partia (botime, dhënie ambjentesh me qera apo kuota antarësie). Përveç raportimit të shpenzimeve në mënyrë të detajuar sipas faturës, formulari ka një hapësirë të posaçme për detajimin e



Nr. 256 i Vendimit Data 08.05.2019 e Vendimit Ora 10.00 e vendimit

Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

shpenzimeve për mitingje të fushatës duke dhënë informacion të detajuar për këtë zë të shpenzimeve.

- Lehtësimin e përpunimit të informacionit nga ana e strukturës së posaçme në KQZ për shqyrtimin e raporteve financiare dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse. Plotësimi i formularit tip do të bëhet në mënyre elektronike dhe do të dorëzohet në KQZ si elektronikisht ashtu edhe në format të printuar. Të dhënat e dërguara elektronikisht do të verifikohen me informacionin e dërguar në mënyrë shkresore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, neni 90, pika 1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15/2, pika 2, gërma (a) neni 24/3, pika 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Miratimin e Formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas modelit, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e udhëzuesit për mënyrën e raportimit financiar nga Partitë Politike për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.
3. Miratimin e udhëzuesit për mënyrën e raportimit financiar nga kandidati për Kryetar Bashkie për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 256 i Vendimit Data 08.05.2019 e Vendimit Ora 10.00 e vendimit

Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.